

Ajeti dhe Vajushi shkelqejne ne Itali

nga Administrator
E diel, 21 Shkurt 2016 20:32



Frosinone e mbrojtësit shqiptar Arlind Ajeti ka arritur të marrë një barazim me vlerë kundër ekipit të Lacios. Në këtë ndeshje Ajeti bëri një paraqitje shumë të mirë, duke qenë ndër më të mirët dhe më të vlerësuarit e skuadrës së tij. Gjithmone pozicional dhe i saktë me ndërhyrjet e tij, nuk i la hapësira sulmuesëve të Lacios si Djordjević apo Klose i cili i aktivizua në pjesën e dytë.

Në ndeshjen e djeshme Livorno - Cesena është aktivizuar për 85 minuta edhe mesfushori me tipare sulmuese Armando Vajushi. Mesfushori shkodran ishte ndër më të mirët për skuadrën e tij dhe u zëvendësua në minutën e 85 nën brohoritjen e tifozëve vendas. I shpejt dhe teknik në krahun e tij dhe shpesh herë duke u sakrifikuar për ekipin. Vazhdon të jetë në rritje dhe tashmë një titullar i padiskutueshem për Livornon.

Lojtaret e tjere ne Itali

Basha - E ka filluar ndeshjen si titullar me ekipin e tij të ri Como, por pa arritur të ndihmojë ekipin për të marrë një rezultat pozitiv. Është zëvendësuar në minutën e 74, kurse Como ka humbur me rezultatin 1-0.

Memushaj - Kapitëni i ekipit të Pescara e ka qenë në formacion dhe është zëvendësuar në minutën e 76. Ekipi i tij ka humbur me rezultatin 2-1.

Xhimshiti - Akoma tranjeri i Atalantes nuk i ka dhënë një shans, ku në këtë ndeshje nuk ka qenë as i grumbulluar.

Berisha - Në ndeshjen kundër Frosinone, ka qëndruar gjatë gjithë kohës në stol.